

VËSHTRIM

Problemi i arsimit universal

Në vend të ndarjes s miliarda dollarëve për përmirësimin e rrethanave, me të njëjtat premtime që ishin dhënë edhe në vitin 1950, bashkësia ndërkombëtare do të duhej të kishte qëllim kryesor transformimin e jetës së miliona fëmijëve të Afrikës Nënshahiane. Kjo qasje, nëse do të zbatohet për të gjitha qëllimet e përfshira në agjendën e ardhshme të zhvillimit të bashkësisë ndërkombëtare, do të siguronte se bota më 2030 do të ishte një vend larg më i mirë

Bjorn Lomborg

Kopenhagë - Me ultimatumin që po arrin shpejt për Qëllimet e zhvillimit të mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara, bota po ngutet për hartimin e një serie të re qëllimesh për 15 vjetet e ardhshme. Duke pasur parasysh burimet e kufizuara, politikebërësit dhe organizatat ndërkombëtare duhet ta pyesin veten: Ku mund ta bëjmë më të mirën? A duhet një hisë më e madhe e 2.5 miliardë dollarëve, që do të drejtohet për ndihmë zhvillimore gjatë kësaj periudhe, dhe buxhetet për zhvillim kombëtar, të drejtohet në shëndetësi, ambient, ushqim, ujë ose arsimit?

Me këto pyetje në mendje, Konsensusi i Kopenhagës (të cilin e drejtoj) ka kërkuar prej disa prej ekonomistëve më të njohur të botës të vlerësojnë kostot dhe dobitë ambientale, sociale dhe ekonomike të shumë caqeve. Arsimi për të gjithë ishte në mesin e qëllimeve që ishin vlerësuar.

Rëndësia e arsimit është e padiskutueshme. Problemi është se kredibiliteti i bashkësisë ndërkombëtare për arsim universal është bërë punë kompromisi: ishte dhënë zotimi se do të arrihej ky qëllim qysh në deklaratën e dymbëdhjetë të sponsorizuar prej Kombeve të Bashkuara më 1950. Ta zëmë, UNESCO-ja premtoi më 1961, pastaj më 1980, se arsimi fillor në Afrikë do të "ishte universal, i detyrueshëm dhe pa pagesë". Megjithatë, kur erdhi koha, gjysma e fëmijëve të moshës së shkollës fillore në Afrikë ende nuk po i ndiqnin mësimet.

Kur kalojnë datat e realizimit të qëllimeve, qëllimet thjesht riformulohen në një kornizë të re kohore dhe më shumë para shpenzohet për atë problem, me pak konsideratë sesi saktësisht do të shpenzohen. Dhe në fakt, qëllimi i sigurimit të arsimit fillor dhe të mesëm do të përfundojë me kosto më të lartë sesa i

gjithë buxheti global që ndahet për arsim.

Me 60 milionë fëmijë që ende mbesin jashtë bankave të shkollave, bashkësia ndërkombëtare thjesht nuk duhet të shtyjë qëllimin e njëjtë të arsimit universal deri më 2030. Në vend të kësaj, është koha të hiqet dorë prej këtyrë qëllimi jorealit në favor të një qasjeje të aritshme dhe me efikasitet më të madh financiar.

Sic ka rekomanduar edhe ekonomisti George Psacharopoulos në një studim të kohëve të fundit, prioriteti kryesor duhet të jetë ai që funksionon më së miri: arsimi fillor, veçanërisht ai parafillor. Arsyet kryesore pse arsimi i hershëm është pikë më e mirë fillestare është se njerëzit janë të prirë të pranojnë gjëra të reja kur janë të rinj. Për më tepër, në moshë të re, ka më pak pengesa kulturore për shkollimin e vajzave, dhe ka më pak presion ndaj fëmijëve për t'u përvjelë punës. Në fund të fundit, arsimi parashkollor është më pak i kushtueshëm për realizim caqesh sesa në arsimin e lartë.

Efektet më afatgjatë të arsimit të hershëm janë më pak të dukshme, por janë thelbësore. Edhe pse nxënësit që kanë ndjekur arsimin parashkollor nuk ia dalin më mirë me mësimet sesa shokët e tyre në fillore, ata shihet se në moshë pjekurie fitojnë më shumë. Kjo sugjeron se shkollimi parashkollor ofron një nxitje të theksuar të zhvillimit të shkathhtësive ose të anës emocionale që ua mundëson atyre të përfitojnë më shumë prej mundësive ekonomike në jetë.

Natyrisht se rikthimi i investimeve është goxha i madh në arsimin parashkollor, por është e vështirë të thuhet se është i tepruar. Por, me qëllim të vënies së prioritetëve të caqeve të zhvillimit, duhet të merren parasysh edhe shifrat.

Së pari, duhet goxha punë që të shtohen kostot e arsimit, si trajnimi dhe kompensimi i mësimitdhënësve, ndërtimi dhe mirëmbajtja e

shkollave, dhe madje kostoja e punës së fëmijëve. Pastaj, ka një proces më të dyanshëm të vlerësimit të dobitë, të cilat, edhe pse është e vështirë të vlerësohen prej anës sasiore, janë mjaftueshëm bindëse që shumë ekonomistë mbështesin arsimin parashkollor.

Bazuar në të dhënat të detajuara të mundshme, Psacharopoulos përshkruan se caku më efektiv do të ishte sa gjysma e numrit të fëmijëve që po ndjekin arsimin parashkollor në Afrikën Nënshahiane, që do të sillte përfitim financiar prej 33 dollarësh për person. Ky qëllim që fokusohet vetëm në një rajon të sfiduar me pengesa të natyrave të ndryshme, mund të jetë modest; por është gjithashtu realist dhe i aritshëm - dhe kthimet potenciale janë masive.

Kur caqet bëhen më ambicioze, humbin ndikimin e tyre. Ta zëmë, zbatimi i programit për arsim parashkollor në Afrikën Nënshahiane do të sillte një përfitim më të ulët, por megjithatë vlera e investimit të një dollari për një person, do të shpërblehej me përfitim prej shtatë dollarësh. Dhe përpjekjet për arritje të qëllimeve mbarëbotërore për arsimin parashkollor do të sillnin përfitim prej 4 dollarësh për person.

I njëjti lloj krahasimi mund të bëhet edhe për qëllimet e tjera të rëndësishme, si përmirësimi i cilësisë së arsimit - një cak që zor se mund të arrihet, siç u është bërë e ditur edhe vendeve në zhvillim për shkak të performancës së tyre në vlerësimin ndërkombëtar të OECD-së. Edhe pse paratë e investuara për reduktimin e madhësive të klasave kanë treguar se kanë dhënë pak ndikim, investimet në sistemin institucional, si në mënyrën e vlerësimit dhe monitorimit, administratën qendrore dhe nismat e dala prej mësimdhënësve, do të mund të rezultojnë me 3 deri në 5 dollarë të kthyer për secilin dollar të investuar.

E sa u përket trajnimeve, ende nuk është nxjerrë ndonjë përfundim shkencor. Por është vlerësuar si më pak profitabil sesa arsimi i përgjithshëm sekondar, duke e bërë mundësi inferiore për investim.

Përpjekjet për ta bërë universitetin mundësi për të gjithë janë edhe më problematike. Duke pasur parasysh se fëmijët e prindërve që kanë kushte të mira jetese kanë më shumë mundësi të ndjekin arsimin e lartë, atëherë do të duhej të investohet më shumë drejt reduktimit të investimeve në kurrriz të të varfërve. Më e udhës do të ishte të ofroheshin bursa për të varfërit dhe taksa për të pasurit.

Duke rritur maksimalisht ndikimin e mungesës së burimeve në jetën e shtresës më të varfër të botës, gjendja vetëm sa vështirësohet. Në një botë ideale, arsimi i përgjithshëm, do të duhej të zbatohet në të gjitha pjesët e botës. Por duke pasur parasysh kërkesat për plotësimin e kushteve të thjeshta për shëndetin dhe ujën, nuk pritet fokusim në arsim. Por qëllimet e arsimit janë themelore për shoqërinë.

Në vend të ndarjes së miliarda dollarëve për përmirësimin e rrethanave, me të njëjtat premtime që ishin dhënë edhe në vitin 1950, bashkësia ndërkombëtare do të duhej të kishte qëllim kryesor transformimin e jetës së miliona fëmijëve të Afrikës Nënshahiane. Kjo qasje, nëse do të zbatohet për të gjitha qëllimet e përfshira në agjendën e ardhshme të zhvillimit të bashkësisë ndërkombëtare, do të siguronte se bota më 2030 do të ishte një vend larg më i mirë.

(Autori është profesor në Shkollën e Biznesit të Kopenhagës. Ka themeluar dhe drejtuar Qendrën e Konsensusit të Kopenhagës. Është autor i shumë librave. Komenti është marrë prej rrjetit botëror të gazetarëve, "Project Syndicate", pjesë e të cilit është edhe "Koha Ditore")

E përditshme e pavarur informative

Themelues: Veton SURROI
Numri i parë u botua më 31 mars 1997Pronare dhe botuese:
Flaka SURROIGazeta redaktohet nga kolegji:
Kryeredaktor: Agron BAJRAMI
Zv. kryeredaktor: Valbona MEHMETI
Redaktor: Brikenda REXHEPI
Redaktor: Elmaz ISUFIZenun ÇELAJ (Portali),
Bekim KUPINA (Kosovë),
Visar LOCI (Sport),
Granit KURTI (Kulturë),
Nita LLESHI & Arbana MJEKIQI (Botë),
Sami KÇIKU (Mes për Mes),
Ben KAJTAZI (Qendra Grafike),
Alban BUJARI & Driton PAÇARADA
(Fotografi)

Telefonat e redaksisë:

038/249-104
249-105; 243 875
Fax: 038/249-106

Fahu postar 202

e-mail: redaksia@kohaditore.com
Marketing: tel & fax: 038/248-880
e-mail: marketing@kohaditore.com
marketing@koha.net

Xhirologjaria:

ProCredit - 1110086926000189
NLB - 1701001010645930
TEB - 2011000000081423
Raiffeisen - 1501001002095874
BKT - 1901217632031247
B. Ekonomike - 1401000000903831
BpB - 13002712000030870Shtypet në Shtypshkronjën "KOHA"
tel. 044/126 367

Marketingu për